REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRISË

**INSTAT: Energjia, "lokomotiva" e zhvillimit ekonomik në 2016**
**2017-04-03 14:08:00**



INSTAT publikoi sot të dhënat për rritjen ekonomike të vitit 2016-s, e cila tejkaloi pritshmëritë, duke u konfirmuar në nivelin e 3.46%.
Megjithatë, ajo që bie në sy është se gjatë vitit të lënë pas, vërehet një ndryshim në strukturën e sektorëve më dinamikë të ekonomisë shqiptare.
Ndërsa turizmi, shërbimet dhe ndërtimi kanë njohur rritje, për herë të parë një tjetër sektor, ai i energjisë elektrike, ka pasur një impakt vendimtar në përshpejtimin me 6.5 pikë përqindje të rritjes ekonomike, krahasuar me 2015-n.
Sektori energjetik, kontributi i të cilit ka qene zakonisht negativ, është shndërruar në një motor të rritjes ekonomike, duke shënuar një rritje prej 30% gjatë 12 muajve të fundit.
Përsa i përket tremujorit të fundit të 2016-s, rritja është edhe më spektakolare, prej 62%.
Konsolidimi i reformës energjetike, reduktimi i humbjeve në rrjet, rritja e investimeve (450 milion euro në tre vitet e fundit), kanë sjellë të gjitha një klimë shumë më pozitive në këtë sektor. Si rrjedhojë e rritjes së vetëmjaftueshmërisë energjetike të Shqipërisë, rritja e eksportit të energjisë dhe si rrjedhojë edhe rritja e punësimit në këtë sektor, kanë dhënë një kontribut vendimtar në rritjen e dinamizmit ekonomik gjatë 2016.
Përveç energjisë, rritje kanë njohur edhe eksportet, me 16% gjatë tremujorit të katërt të 2016, ndërsa ka njohur rritja me 2.47% edhe konsumi final i popullatës, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi.
Rritja ekonomike prej 3.46 është më e larta që prej minimumit historik të 2013-s, kur rritja prej vetëm 0.9% ishte më e dobëta që prej vitit 1997.